



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË
KORÇË.

VENDIM

Nr 114 Datë 31.10.08

PER

**Miratim fondi për përballimin e shpenzimeve të varrimit për invalidin e luftës
(të ndjerin) z. Taqo Luarasi**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës "Miratim fondi për përballimin e shpenzimeve të varrimit për invalidin e luftës (të ndjerin) z. Taqo Luarasi", bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32 pika dh, ligjin nr. 9836 dt. 26.11.2007 «Për buxhetin e Shtetit të vitit 2008», Udhëzimin nr.4 dt.17.01.08 i M.F «Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2008», Udhëzimin nr 258 dt. 15.02.2008 i Ministrisë së Brendshme «Për zbatimin e buxhetit të qeverisjes vendore për vitin 2008 », V.K.B nr. 12 dt. 18.03.2008 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2008», Ligji nr. 9936 dt. 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë» si dhe V.K. Ministrave nr. 332 dt. 29.05.2003 "Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 326 dt. 21.06.1993 të Këshillit të Ministrave për Kriteret e Trajtimit të invalidëve të Luftës kundër pushtuesve Nazifashistë të Popullit Shqiptar", sipas pikës 5/c mbështetur në kompetencat që ka, mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 150,000-lekë për përballimin e shpenzimeve të varrimit familjes së të ndjerit z. Taqo Luarasi.
2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00	04980 05	Art 6090000	-150,000 lekë
Shtohet	00	01110 05	Art 6061001	+150,000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari
Raimonda Nase
Raimonda Nase